

агенција за давање услуги за чување и нега на деца од предучилишна возраст и член 87 став (1) алинеја 1 за физичко лице кое самостојно врши одредени работи од дејноста згрижување и воспитување на деца како професионална дејност.“

#### Член 19

Во членот 177-ј став (5) по зборот „комисијата“ се додаваат зборовите: „или административно лице од министерството“.

#### Член 20

Во членот 228 став (1) по алинејата 18 се додава нова алинеја, која гласи:

„ - на родителите не им ги претстави и не им дозволи да изберат прирачници и детски списанија кои се во функција за реализација на активностите во установата за деца (член 173 ставови (4) и (5)).“

#### Член 21

Подзаконските акти предвидени со овој закон, министерот ќе ги донесе во рок од три месеци од денот на влегувањето во сила на овој закон.

#### Член 22

Се овластува Законодавно-правната комисија на Собранието на Република Македонија да утврди прецисен текст на Законот за заштита на децата.

#### Член 23

Одредбите од членот 2 од овој закон ќе отпочнат да се применуваат од 1 декември 2016 година.

Одредбите од членовите 17 и 18 од овој закон ќе отпочнат да се применуваат со денот на отпочнувањето на примената на одредбите од членовите 12 и 29 од Законот за изменување и дополнување на законот за заштита на децата („Службен весник на Република Македонија“ број 12/14).

#### Член 24

Овој закон влегува во сила осмиот ден од денот на објавувањето во „Службен весник на Република Македонија“.

### L I G J

#### PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJE TË FËMIJËVE

##### Neni 1

Në Ligjin për mbrojtjen e fëmijëve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 23/13, 12/14, 44/14, 144/14 dhe 10/15), në nenin 16 pas paragrafit (3) shtohen tre paragrafë të rinj (4), (5) dhe (6), si vijojnë:

"(4) Përkujdesja dhe edukimi i fëmijëve mund të organizohet dhe të sigurohet edhe në kopsht për fëmijë/qendër për zhvillim të hershëm, të themeluar nga dhe në përbërje të personave juridikë për nevojat e të punësuarve të tyre, në pajtim me kushtet e përcaktuara në këtë ligj, si dhe njësinë organizuese në përbërje të personit juridik, me të cilin do të udhëheq person i cili i plotëson kushtet në pajtim me këtë ligj, i emëruar nga personi përgjegjës në personin juridik.

(5) Në përbërje të institucionit të lartë arsimor në kuadrin profesional për edukim parashkollor, në funksion të realizimit më të suksesshëm të veprimtarisë praktike të fakultetit, mund të themelohet kopshti për fëmijë/qendra për zhvillim të hershëm të fëmijëve si njësi organizative në pajtim me kushtet e përcaktuara me ligj.

(6) Në përbërje të shkollës private që ka cilësi të personit juridik dhe është e regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë në pajtim me ligjin, mund të themelohet kopsht i fëmijëve/qendër për zhvillim të hershëm të fëmijëve si njësi organizativ në pajtim me kushtet e përcaktuara me këtë ligj."

##### Neni 2

Në nenin 41 pas paragrafit (1) shtohet paragraf i ri (2), si vijon:

"(2) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, procedura për realizimin/vazhdimin e të drejtës së shtesës fëmijërore, mund të ngrihet përmes aplikimit elektronik të dorëzuar në Qendrën për Punë Sociale."

Paragrafët (2), (3), (4), (5), (6) dhe (7) bëhen paragrafë (3), (4), (5), (6), (7) dhe (8).

##### Neni 3

Në nenin 73 paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

"Në përbërje të kopshtit publik për fëmijë, përkatësisht kopshtit për fëmijë në pronësi private mund të formohet qendër për zhvillim të hershëm të fëmijëve me vendim të themeluesit me kushte të përcaktuara me këtë ligj, i cili do të funksionojë në pjesën e objektit ekzistues ose në objekt tjetër të ndarë nga kopshti i fëmijëve."

Në paragrafin (5) fjalët: "personat e rinj juridikë" zëvendësohen me fjalën "themeluesit".

##### Neni 4

Në nenin 78 paragrafi (5) në rreshtin e tretë pas fjalës "moshë" shtohen fjalët: " në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit".

##### Neni 5

Në nenin 88 paragrafi (4) pas fjalëve: "ligj" shtohen fjalët: " në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit".

##### Neni 6

Në nenin 100 paragrafi (3) pas fjalëve: "të ushqyerit" vihet presje dhe shtohen fjalët: "standardet për ushqyerje dhe shujta".

##### Neni 7

Në nenin 102 paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

"Institucioni për fëmijë mund të fillojë me punë pasi që pas kërkesës për kryerjen e veprimtarisë nga themeluesi, ministri do të konstatojë se janë plotësuar kushtet e përcaktuara me këtë ligj dhe rregullat tjera, dhe do të miratojë aktvendim për kryerjen e veprimtarisë."

Në nenin 4 paragrafi (15) pas fjalëve: "institucioni për fëmijë" shtohen fjalët: " në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit".

##### Neni 8

Pas nenit 102 shtohet nen i ri 102-a, si vijon:

##### "Neni 102 -a

(1) Kopshti i fëmijëve/qendra e fëmijëve për zhvillim të hershëm të fëmijëve, si njësi organizative e themeluar nga dhe në përbërje të personave juridikë, institucioni i arsimit të lartë dhe shkolla private nga neni 16 paragrafët (4), (5) dhe (6) të këtij ligji, mund të fillojë me punë pas aktit të miratuar paraprakisht për themelim të kopshtit të fëmijëve/qendrës për zhvillim të hershëm të fëmijëve si njësi organizative, pas kërkesës së parashtruar dhe marrjes së aktvendimit për kryerjen e veprimtarisë në pajtim me nenin 102 të këtij ligji.

(2) Për njësinë organizuese nga neni 16 paragrafët (4), (5) dhe (6) të këtij ligji në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat e këtij ligji të cilat kanë të bëjnë me fillimin me punë të institucionit për fëmijë, të kuadrit në institucionet private për fëmijë, mbikëqyrjen e punës së institucioneve për fëmijë, mbikëqyrjen inspektuese të evidencës dhe dokumentacionit në sferën e përkujdesjes dhe edukimit të fëmijëve dhe programeve për kryerjen e veprimtarisë.

(3) Për fillimin me punë të objektit të ri në përbërje të institucionit për fëmijë, themeluesi pas vendimit të miratuar dhe mendimit të marrë nga Ministria parashtron kërkesë te ministri, ndërsa pas mendimit të marrë të komisionit nga neni 102 paragrafi (2) të këtij ligji, ministri miraton aktvendim për kryerjen e veprimtarisë së institucionit për fëmijë nëse janë plotësuar kushtet e këtij ligji.

(4) Në rast ndryshimit të selisë/ kushteve hapësinore të institucionit për fëmijë, njësisë organizuese në përbërje të personit juridik, kopshtit/qendrës fëmijërore për zhvillim të hershëm fëmijëror në përbërje të institucionit të lartë arsimor, pas kërkesës së parashtruar nga themeluesi, ndërsa pas mendimit të komisionit nga neni 102 paragrafi (2) të këtij ligji, ministri miraton aktvendim për ndryshimin e kushteve selisë/hapësirave."

#### Neni 9

Në nenin 104 fjalët: "punë të caktuara nga" shlyhen.

#### Neni 10

Pas nenet 113 shtohet nen i ri 113-a, si vijon:

#### "Neni 113 -a

(1) Nëse ministri nuk miraton aktvendim në pajtim me nenet 78 paragrafi (3), 88 paragrafi (2) dhe 102 paragrafi (1) të këtij ligji, përkatësisht nuk e refuzon kërkesën për miratimin e aktvendimit në afat prej 60 ditësh nga parashtruesi i kërkesës ka të drejtë në afat prej tri ditësh pune pas kalimit të atij afati të parashtrorë kërkesë në sekretarinë e ministrit për miratimin e aktvendimit dhe ministri të miratojë aktvendim.

(2) Formën dhe përmbajtjen e kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni e përcakton ministri.

(3) Me kërkesën për miratimin e aktvendimit nga paragrafi (1) i këtij neni parashtruesi i kërkesës dërgon edhe kopje nga kërkesa e neneve 78 paragrafi (1), 88 paragrafi (1) dhe 102 paragrafi (1) të këtij neni.

(4) Ministri obligohet që në afat prej pesë ditësh pune nga dita e parashtrimit të kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni, në sekretarinë e ministrit të dërgojë aktvendim me të cilin kërkesa për marrjen e aktvendimit është pranuar ose refuzuar. Nëse ministri nuk ka sekretari, kërkesa parashtrohet në sekretari të Ministrisë.

(5) Nëse ministri nuk miraton aktvendim në afatin nga paragrafi (4) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund ta njoftojë Inspektoratin Administrativ Shtetëror në afat prej pesë ditësh pune.

(6) Inspektorati Administrativ Shtetëror obligohet në afat prej dhjetë ditëve nga dita e pranimit të njoftimit nga paragrafi (5) i këtij neni të bëjë mbikëqyrje të Ministrisë nëse është realizuar procedura në pajtim me ligj dhe në afat prej tri ditëve nga dita e mbikëqyrjes së kryer të informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(7) Inspektori nga Inspektori Administrativ Shtetëror pas mbikëqyrjes së kryer në pajtim me ligj miraton aktvendim me të cilin e obligon ministrin në afat prej 10 ditësh të vendosë për kërkesën e parashtruar, përkatësisht

ta miratojë ose ta refuzojë kërkesën dhe ta njoftojë inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftimin dërgohet edhe kopje nga akti me të cilin ka vendosur për kërkesën e parashtruar.

(8) Nëse ministri nuk ka vendosur në afatin e paragrafit (7) të këtij neni, inspektori do të parashtrorë kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje të përcaktuar në Ligjin për inspeksion administrativ dhe do të përcaktojë afat plotësues prej pesë ditësh pune, në të cilat ministri do të vendos për kërkesën e parashtruar për çka në afatin e njëjtë do ta njoftojë inspektorin për aktin e miratuar. Me njoftimin dërgohet edhe kopje nga akti me të cilin ka vendosur për kërkesën e parashtruar. Inspektori në afat prej tri ditësh pune do ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(9) Nëse ministri nuk vendos edhe në afatin plotësues nga paragrafi (8) i këtij neni, inspektori në afat prej tri ditësh pune do të parashtrorë kallëzim te prokurori publik dhe në atë afat do ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(10) Nëse inspektori nuk ka vepruar sipas njoftimit nga paragrafi (5) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës në afat prej pesë ditësh pune ka të drejtë të parashtrorë kundërshtim në sekretarinë e drejtorit të Inspektoratit Administrativ Shtetëror. Nëse drejtori nuk ka sekretari, kundërshtimi parashtrohet në arkivin e selisë të Inspektoratit Administrativ Shtetëror.

(11) Drejtori i Inspektoratit Administrativ Shtetëror obligohet në afat prej tri ditësh pune nga dita e pranimit ta shqyrtojë kundërshtimin nga paragrafi (10) i këtij neni dhe nëse konstaton se inspektori nuk ka vepruar në bazë të njoftimit nga parashtruesi i kërkesës nga paragrafi (5) i këtij neni ose nuk parashtron kallëzim në pajtim me paragrafin (9) të këtij neni, drejtori i Inspektoratit Administrativ Shtetëror do të parashtrorë kërkesë për ngritjen e procedurës për kundërvajtje për kundërvajtje të përcaktuar në Ligjin për inspeksion administrativ dhe do të përcaktojë afat plotësues prej pesë ditësh pune në të cilat inspektori do të kryejë mbikëqyrje në organin kompetent nëse është realizuar procedura në pajtim me ligj dhe në afat prej tri ditësh pune nga dita e mbikëqyrjes së kryer do ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(12) Nëse inspektori nuk vepron edhe në afatin plotësues nga paragrafi (11) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Administrativ Shtetëror do të parashtrorë kallëzim te prokurori publik kompetent dhe në afat prej tri ditësh pune do ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(13) Në rastin e paragrafit (12) të këtij neni drejtori i Inspektoratit Administrativ Shtetëror menjëherë, ndërsa më së voni në afat prej një ditësh pune do ta autorizojë inspektorin që ta realizojë mbikëqyrjen menjëherë.

(14) Në rastet nga paragrafi (13) i këtij neni, drejtori i Inspektoratit Administrativ Shtetëror në afat prej tri ditësh pune do ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(15) Nëse drejtori i Inspektoratit Administrativ Shtetëror nuk vepron në pajtim me paragrafin (11) të këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund të parashtrorë kallëzim deri te prokurori publik kompetent në afat prej tetë ditësh pune.

(16) Nëse ministri nuk vendos në afatin nga paragrafi (9) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund të ngrit kontest administrativ në gjykatën kompetente.

(17) Procedura në Gjykatën Administrative është urgjente.

(18) Pas miratimit të aktit nënligjor nga paragrafi (2) i këtij neni ai menjëherë, ndërsa më së voni në afat prej 24 orësh e publikon në ueb faqen e Ministrisë."

Neni 11

Në nenin 120 paragrafi (2) pas fjalës "jurist" vihet presje dhe shtohet fjala "sociolog".

Paragrafi (12) shlyhet.

Neni 12

Pas nenit 120 shtohet nen i ri 120-a, si vijon:

"Neni 120 -a

(1) Si drejtor i institucionit për fëmijë - kopsht/qendër për zhvillim të hershëm të fëmijëve mund të zgjidhet personi i cili përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj dhe kushteve të përcaktuara në nenin 142 të këtij ligji është me arsim të lartë (me 240 pikë të fituara sipas SETK-së ose me shkallën VIII të përfunduar) dhe i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 167 të këtij ligji për edukator, për punëtor profesional, për bashkëpunëtor profesional, person me fakultet filologjik të kryer- program studimor mësimor dhe studime të specializuara për pedagog parashkollor, jurist dhe ekonomist me arsim të lartë (me 240 pikë të fituara sipas SETK-së ose me shkallën VIII të përfunduar) dhe posedon licencë të vlefshme për drejtor për institucion për fëmijë.

(2) Si drejtor i institucionit privat për fëmijë - kopsht/qendër për zhvillim të hershëm të fëmijëve mund të zgjidhet personi i cili përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj dhe kushteve të përcaktuara në nenin 142 të këtij ligji është me arsim të lartë (me 240 pikë të fituara sipas SETK-së ose me shkallën VIII të përfunduar) dhe posedon licencë të vlefshme për drejtor për institucion për fëmijë.

(3) Personi i cili udhëheq me njësinë organizative në përbërje të personit juridik nga neni 16 paragrafi (4), (5) dhe (6) të këtij ligji, duhet t'i plotësojë kushtet nga paragrafi (1) i këtij neni."

Neni 13

Në nenin 130 paragrafi (4) në alinenë 3 fjalët: "emëron dhe shkarkon" zëvendësohen me fjalën "propozon".

Neni 14

Në nenin 168 pas paragrafit (12) shtohet paragraf i ri (13), si vijon:

"(13) Puna edukativo-arsimore në kopshtin e fëmijëve, përkatësisht qendrën për zhvillim të hershëm të fëmijëve, për fëmijë me pengesa në zhvillim realizohet sipas programit për mësim dhe zhvillim të hershëm për fëmijë me pengesa në zhvillim të bazuar në Standardet për mësim dhe zhvillim të hershëm, të cilin e përpilon Byroja për Zhvillimin e Arsimit, ndërsa e miraton ministri."

Paragrafët (13) dhe (14) bëhen paragrafë (14) dhe (15).

Neni 15

Në nenin 172 paragrafi (2) pas fjalës "institucioni" vihet presje dhe shtohet fjala "themeluesi".

Neni 16

Në nenin 173 pas paragrafit (3) shtohen dy paragrafë të rinj (4) dhe (5), si vijojnë:

"(4) Institucioni për fëmijë obligohet më së voni deri në muajin tetor në vitin aktual në takimet prindërore, tabelat e lajmërimit dhe në ueb faqen e institucionit, prindërve tua prezantojë doracakët dhe revistat e fëmijëve të cilat janë lejuar me aktvendim nga ministri.

(5) Prindërit kanë të drejtë për fëmijët e tyre në institucionin për fëmijë të zgjedhin doracakë dhe revista të cilat janë në funksion për realizimin e aktiviteteve edukativo-arsimore."

Neni 17

Neni 176 ndryshon si vijon:

"Komisioni nga neni 175 i këtij ligji përbëhet nga nëntë anëtarë edhe atë nga: Ministria e Punës dhe Politikës Sociale- katër anëtarë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës- një anëtar, Ministria e Financave - një anëtar, Byroja për Zhvillimin e Arsimit - një anëtar dhe nga fakultetet dhe institutet për shkenca shoqërore humanitare - dy anëtarë."

Neni 18

Në nenin 177-a paragrafin (2) alineja 1 ndryshon si vijon:

"- të ketë diplomë ose vërtetim për arsim të kryer në pajtim me nenin 120 paragrafët (2) dhe (3) për drejtor të institucioneve për fëmijë, nenin 136 paragrafët (1), (2), (3), (4) dhe (5) për ofrues të shërbimeve publike për përkujdesje dhe edukim të fëmijëve në institucione publike për fëmijë, nenin 167 paragrafi (1) pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7 për persona profesionalë për përkujdesje dhe edukim të fëmijëve në institucione private për fëmijë, nenin 77 paragrafi (1) alineja 1 për personi i angazhuar nga agjencia për dhënie e shërbimeve për ruajtje dhe kujdes të fëmijëve në moshë parashkollore dhe nenin 87 paragrafi (1) alineja 1 për personin fizik i cili në mënyrë individuale kryen punë të caktuara nga veprimtaria përkujdesje dhe edukim të fëmijëve si veprimtari profesionale."

Neni 19

Në nenin 177-j paragrafi (5) pas fjalës "komisioni" shtohen fjalët: "ose personi administrativ i ministrisë".

Neni 20

Në nenin 228 paragrafi (1) pas alinesë 18 shtohet aline e re, si vijon:

"-prindërve nuk ua prezanton dhe nuk u lejon të zgjedhin doracakë dhe revista për fëmijë të cilat janë në funksion për realizimin e aktiviteteve në institucion për fëmijë (neni 173 paragrafët (4) dhe (5))".

Neni 21

Aktet nënligjore të paraparë me këtë ligj, ministri do t'i miratojë në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 22

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve.

Neni 23

Dispozitat e nenit 2 të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen nga 1 dhjetori 2016.

Dispozitat e neneve 17 dhe 18 të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen në ditën e fillimit të zbatimit të dispozitave të neneve 12 dhe 29 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për mbrojtje të fëmijëve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 12/14).

Neni 24

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".